URDHËR
Nr. 177, datë 2.8.2024

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS PËR SHPALLJEN DHE PËRZGJEDHJEN E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË ALBCONTROL-it"

Bazuar në pikën 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe në pikën 6, të nenit 12, të ligjit nr. 40/2024, "Për ofruesin e shërbimeve të lundrimit ajror 'Albcontrol'";

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores "Për përcaktimin e procedurës për shpalljen dhe përzgjedhjen e drejtorit të përgjithshëm të Albcontrol-it", sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohet Albcontrol-i për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

RREGULLORE
PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS PËR SHPALLJEN DHE PËRZGJEDHJEN E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË *ALBCONTROL-it*

Neni 1
Objekti

1.1 Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurës për shpalljen dhe përzgjedhjen e kandidatit për drejtor të përgjithshëm të *"Albcontrol-it"*.

Neni 2
Parimet e përgjithshme

2.1 Përzgjedhja e kandidatit për drejtor të përgjithshëm bëhet sipas një procedure të bazuar në parimin e mosdiskriminimit, meritës, transparencës dhe profesionalizmit.

Neni 3
Publikimi i thirrjes

3.1 Me vendim të Këshillit Drejtues, struktura përgjegjëse për burimet njerëzore në *Albcontrol,* shpall thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit për pozicionin vakant të drejtorit të përgjithshëm.

3.2 Thirrja publikohet në faqen zyrtare të *Albcontrol-it* si dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

3.3 Në rast të mungesës së konkurencës apo mos kualifikimit të asnjë prej kandidatëve, procedura e publikimit të thirrjes, përsëritet.

Neni 4

Paraqitja e shprehjes së interesit dhe dokumentacionit shoqërues

4.1 Kandidati për drejtor të përgjithshëm përcjell zyrtarisht pranë *Albcontrol-it,* shprehjen e interesit dhe dokumentacionin shoqërues brenda 5 (pesë) ditëve-pune nga data e publikimit të thirrjes.

4.2 Shprehja e interesit përmban:

a) emrin, mbiemrin, atësinë, datëlindjen, vendlindjen, numrin personal të identifikimit të kandidatit;

b) adresën e vendbanimit, adresën elektronike si dhe numrin e telefonit të kandidatit;

c) arsyet e aplikimit, duke përfshirë motivimin, idetë dhe vizionin.

4.3 Së bashku me shprehjen e interesit, për të provuar përmbushjen e kritereve ligjore, kandidati paraqet dokumentacionin si vijon:

a) kopje të mjetit të identifikimit;

b) jetëshkrimin;

c) kopje të njehsuar me origjinalin të diplomës "Master i shkencave" apo "Master profesional", të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike në shkenca shoqërore, inxhinieri ose aviacion;

ç) vërtetim që për të nuk është marrë masë disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi.

d) kopje të librezës së punës të njehsuar me origjinalin;

dh) dëshmi penaliteti;

e) vërtetim mjekësor që është i aftë për punë;

ë) vetëdeklarim se nuk gjendet në konflikt interesi me detyrën, në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi;

f) vërtetime dhe/ose certifikata për kualifikimet që ka.

Neni 5

Verifikimi i plotësimit të kritereve dhe shpallja e fituesit

5.1 Brenda afatit prej 2 (dy) ditë-pune nga dorëzimi i shprehjes së interesit, dy përfaqësues të strukturës përgjegjëse për burimet njërëzore dhe Sekretari i Këshillit Drejtues të *Albcontrol-it*, verifikojnë nëse kandidatët plotësojnë kriteret ligjore.

5.2 Nëse konstatohet se dokumentacioni i paraqitur nga kandidati ka mangësi, Sekretari i Këshillit Drejtues njofton menjëherë kandidatin në rrugë elektronike për plotësimin e mangësive brenda 2 (dy) ditë-pune. Nëse kandidati nuk përcjell dokumentacionin e kërkuar brenda afatit, shprehja e tij e interesit refuzohet.

5.3 Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit, dy përfaqësues të strukturës përgjegjëse për burimet njerëzore dhe Sekretari i Këshillit Drejtues hartojnë dhe përcjellin pranë Këshillit Drejtues të *Albcontrol-it*, listën e kandidaturave dhe një relacion përmbledhës për secilin kandidat.

5.4 Këshilli Drejtues interviston kandidatët e përcjellë nga struktura përgjegjëse për burimet njerëzore dhe Sekretari i Këshillit Drejtues, për motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

5.5 Këshilli Drejtues përzgjedh kandidaturën fituese nga radhët e kandidatëve të kualifikuar dhe e propozon për emërim te ministri.

Neni 6

Njoftimi i kandidatit fitues

6.1 Kandidati fitues shpallet në faqen zyrtare të *Albcontrol-it*, në faqen zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe njoftohet me shkrim.

6.2 Kandidatët e tjerë njoftohen me shkrim individualisht për mospërzgjedhjen, si dhe për shkaqet e refuzimit apo të skualifikimit, nëse ka të tilla.

Neni 7

Dispozita të fundit

7.1 Në rast se, struktura përgjegjëse për burimet njerëzore pranë *Albcontrol*-it nuk është konstituuar apo nuk mund të kryejë detyrat e përcaktuara në këtë rregullore për shkak të mosplotësimit të vendeve vakante, detyrat dhe përgjegjësitë e tij ushtrohen nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.